



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KONTRATA

E përpiluar me datën 17.05.2018 ne Lipjan ndërmjet:

- Komunës së Lipjanit të cilën e përfaqëson Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan
z. Adem Duriqi ne njërën anë (në tekstin e mëtejme) Autoriteti Kontraktues dhe

Emri i Kontraktuesit Operatori ekonomik NTP "Elektro Sistem" nga Lipjani të cilin e përfaqëson
Isa Dragaqina drejtor në vazhdim përdoret (shkurtesa) Kontraktuesi

Titulli i Kontratës: "Furnizimi i disa shkollave me gjenerator-Ritenderim"

Nr referues i kontratës 613 018 016 136

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është: "Furnizimi i disa shkollave me gjenerator-Ritenderim" të gjitha
këto të parapara në paramasën dhe paralogarin e cila është pjesë e kontratës dhe dosjes së
kuotimit të çmimeve

1.2 Kontrata hynë në fuqi me vënien e nënshkrimit nga të dy palët ,gjegjësisht me 17.05.2018
dhe përfundon me "Furnizimi i disa shkollave me gjenerator-Ritenderim" sipas paramasës
dhe paralogarisë e cila është pjesë e kontratës dhe dosjes së kuotimit të çmimeve

1.3 Afati kohor i kryerjes së punëve nuk mund të jetë më shumë se 10 ditë nga data e marrjes së
urdhrit nga menaxheri për fillimin e furnizimeve.

1.4 Vendi i kryerjes së furnizimeve janë shkollat: "Emin Duraku"-Banullë, "Ernest Koliqi"-
Babush i Muhaxherëve, "Hasan Zyko Kamberi"-Sllovi, "Shtjefën Gjeqovi"-Janjevë, "Katër
Dëshmorët"-Krojmir, "Haradin Bajrami"- Magurë, "Nezë Bujani-Bujan në PNF Bregu i Zi1.5
Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të
kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata Komunale Lipjan.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi përgjithshëm i kontratës shprehur në shifra është 4,676.00 € me fjalë katërmijë e
gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë /euro/ e zero /cent/

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të bëhet në baza të raportit të menaxherit.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën e përgjithshme të pagesës pas kryerjes së të gjitha furnizimeve.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës nëse fatura e ka të bashkangjitur raportin e menaxherit të kontratës së shërbimit janë kryer me cilësi dhe në afat sipas planit dinamik të paraparë në kontratë. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Kontraktuesi duhet të garantojë që furnizimet janë të reja, të papërdorura, të modelit më të fundit dhe që inkorporojnë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në material. Kontraktuesi do të garantojë se asnjë nga furnizimet nuk kanë asnjë defekt që shkaktohet në materialet dhe kryejnë funksionin pa pengesa.

Kontraktuesi me rastin e nënshkrimit të kontratës është i obliguar që të bëjë sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej 1000€ në kohëzgjatje prej 1 viti

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet, brenda limiteve kohore të specifikuara në

kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që të inspektojë, kontrollojë, materialet, të cilat do të dorëzohen sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Menaxher i kontratës është: Brahim Duriqi – shef në DKA.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën komunale në Lipjan në pajtim me ligjin e Kosovës.





Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqip në 4 origjinale, 3 origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Adem Duriqi	Emri:	Isa Dragaqina
Pozita:	Drejtor i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	17.05.2018	Data:	17.05.2018
Vula:		Vula:	

Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Nr. i Artikullit	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Cmimi njësi €	Cmimi total €
1	Furnizimi me gjenerator 5 KW Lëndë Djegëse Diesel 3 fazor	Copë	7	668.00	4,676.00
Totali i Përgjithshëm:					4,676.00€